

**KUVENDI I KËSHILLIT NACIONAL TË SHQIPTARËVE
- ORGANI EKZEKUTIV -**

**REGULLORE
E ORGANIT EKZEKUTIV E KËSHILLIT NACIONAL TË SHQIPTARËVE**

Bujanoc, janar 2011

Në bazë të nenit 7 të Statutit të Këshillit Nacional të Shqiptarëve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë" numër), Organi ekzekutiv i Këshillit Nacional të Shqiptarëve, në mbledhjen e mbajtur më 13.01.2011, miratoi

RREGULLOREN

e Organit ekzekutiv të Këshillit Nacional të shqiptarëve

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore rregullohen mënyra e punës së Organit ekzekutiv (në tekstin e mëtejshëm: Ekzekutivi); të drejtat dhe obligimet e kryetarit, nënkryetarit dhe të anëtarëve të Ekzekutivit; transparenca e punës së Ekzekutivit; kryerja e punëve profesionale, administrative dhe punëve të tjera për nevojën e Ekzekutivit.

Për çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, ndërsa kanë të bëjnë me mënyrën e punës së Ekzekutivit, zbatohen dispozitat e Rregullores së Kuvendit të Këshillit nacional të shqiptarëve.

II. Mënyra e punës së Ekzekutivit

Neni 2

Mbledhjet e Ekzekutivit i thërret kryetari i Ekzekutivit.

Kryetari ka për detyrë që të thërrasë mbledhje edhe nëse këtë e propozojnë së paku një e treta e anëtarëve të Ekzekutivit.

Kryetari i Ekzekutivit, ua dorëzon anëtarëve të Ekzekutivit thirrjen për mbledhjen me propozimin e rendit të ditës dhe me materialet që do të shqyrtohen, sipas rregullës pesë ditë para mbajtjes së mbledhjes.

Materialet e shkruara në gjuhë të huaj, detyrimisht dorëzohen me përkthim në gjuhën shqipe.

Me përjashtim, për çështje urgjente materialet mund të dorëzohen edhe në gjuhë të huaj, me ç'rast përkthimi doemos duhet të sigurohet deri në mbajtjen e mbledhjes së Ekzekutivit.

Neni 3

Rendi i ditës për mbledhjen e Ekzekutivit verifikohet në fillim të mbledhjes.

Kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e Ekzekutivit kanë të drejtë të propozojnë ndryshime dhe plotësime të rendit të ditës të propozuar.

Rendi i ditës miratohet me shumicë të anëtarëve prezentë të Ekzekutivit.

Neni 4

Ekzekutivi punon dhe vendos nëse në mbledhje janë prezent shumica e anëtarëve të cilët kanë të drejtë të vendosjes.

Ekzekutivi vendos me shumicë të anëtarëve të cilët kanë të drejtë të vendosjes.

Neni 5

Për punën e mbledhjes mbahet procesverbal.

Procesverbali përmban të dhëna për kohën e mbajtjes së mbledhjes, rendin e ditës, praninë dhe pjesëmarrjen e anëtarëve në diskutim, rrjedhën e diskutimit dhe vendosjen.

Procesverbalet miratohen para caktimit të rendit të ditës.

Çdo anëtar i Ekzekutivit ka të drejtë të japë vërejtje për procesverbalin e mbledhjes së kaluar. Për arsyetimin e vërejtjeve vendoset pa diskutim. Vërejtjet e miratuara futen në procesverbal.

Procesverbalin e miratuar e nënshkruan kryetari dhe procesmabjtësi.

Neni 6

Procesverbali me materialet e mbledhjes ruhen në arhivën e Këshillit nacional të shqiptarëve.

Neni 7

Për shkak shqyrtimit të çështjeve të veçanta specifike nga kompetenca e vet si dhe për përgatitjen e analizave, mendimeve dhe raporteve, Ekzekutivi mund të formojë grupe të punës.

Grupet e punës punojnë ekskluzivisht në kuadër të Ekzekutivit dhe nuk mund të veprojnë në mënyrë të pavarur.

Ekzekutivi mund të thërrasë që në mbledhje të jenë prezentë dhe të marrin pjesë në punë edhe përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave tjera kur shqyrtohen çështje nga kompetenca e tyre.

Neni 8

Ekzekutivi së paku katër herë në vit e njofton Kuvendin për punën e vet.

Raporti dorëzohet në formë të shkruar, ndërsa në mbledhjen e Kuvendit e arsyeton kryetari i Ekzekutivit, përkatësisht në rast të pengesës ose mungesës së tij, nënkryetari i Ekzekutivit.

III . Të drejtat dhe obligimet e kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Këshillit

Neni 9

Kryetari i Ekzekutivit e organizon punën e Këshillit, i thërret mbledhjet, e propozon rendin e ditës dhe kryeson me mbledhjet. Kryetari i nënshkruan mendimet, konkluzionet dhe vendimet që i verifikon Ekzekutivi për çështjet nga kompetencat e veta.

Kryetari kujdeset për zbatimin e konkluzioneve të Ekzekutivit dhe Kuvendit që kanë të bëjnë me çështjet nga kompetenca e Ekzekutivit dhe kryen punë të tjera të verifikuara me Vendimin për themelimin e Ekzekutivit dhe me këtë rregullore.

Neni 10

Nënkryetari i Këshillit, në rast të pengesës ose mungesës së kryetarit, i ka të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tij të verifikuara me Vendimin për themelimin e Ekzekutivit dhe me këtë rregullore.

Në rast të pengesës ose mungesës së kryetarit dhe të nënkryetarit, me mbledhjen e Ekzekutivit kryeson anëtar i Ekzekutivit i autorizuar nga kryetari.

Neni 11

Çdo anëtar i Ekzekutivit ka të drejtë dhe detyrë të jetë prezent në mbledhjet e Ekzekutivit, të marrë pjesë në punën e tij dhe në punën e grupeve punuese, të inicioj thirrjet e mbledhjeve të Ekzekutivit të kërkoj njoftim për çështje me kompetencë të Ekzekutivit.

IV Transparenca në punën e Ekzekutivit

Neni 12

Mbledhjet e Ekzekutivit janë transparente.

Ekzekutivi mund të vendos të punojë pa prezencën e opinionit nëse këtë e propozojnë kryetari i Ekzekutivit ose së paku një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Ekzekutivit. Pas propozimit, Ekzekutivi vendos me konsensus të anëtarëve prezentë të Ekzekutivit.

Në rastet nga paragrafi 2 i këtij neni, Ekzekutivi jep komunikatë për mjetet e informimit publik.

Neni 13

Transparenca në punën e Këshillit sigurohet edhe me:

- dhënien e deklaratave nga ana e kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Këshillit për mjetet e informimit publik;
- mbajtjen e konferencave për mjetet e informimit publik;
- publikimin e mendimeve dhe orientimeve që Ekzekutivi i ka verifikuar për çështjet nga kompetenca e vet.

Neni 14

V Dispozita përfundimtare

Neni 15

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e miratimit.

Numër

Bujanoc

KRYETARI I EKZEKUTIVIT

Hamdi Fejzullahu